



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



| | | | |
|----------|----------|---------|--|
| Dat | 29.03.18 | Vendi | KAÇANIK |
| Nj. org. | | Shtojcë | KOMUNA KAÇANIK |
| | 08 | Numri | 322/01-10147 |
| | | | Opština Kaçanik Municipaliti of Kacanik |

Në bazë të vendimit 01Nr. 08-320-40509/2015 të datës 30.11.2015 të Asamblesë Komunale, dhe Pëlqimit nga MBPZHR nr. 2504 të datës 27.10.2015, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, Komuna Kaçanik rishpallë;

OFERTË PUBLIKE

Për dhënien në menaxhim të vend gjuetisë së përbashkët të emëruar : “Lybeteni” e cila gjendet në territorin e Komunës së Kaçanikut me sipërfaqe të përgjithshme prej 18,904 ha.

Kushtet e përcaktuara për ofertues (sipas UA Nr. 06/2009) janë:

1. Dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë
2. Dëshmia mbi përvojën e punës në menaxhimin me kafshë të egra dhe gjueti (kjo vlen për menaxhuesit e gjertanishëm me gjueti - shoqatat e gjuetisë) nga Federata e gjahtarëve të Kosovës, si dhe përshkrimin e rezultateve menaxhuese nga vitet paraprake;
3. Dëshmi mbi Përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme – për subjektet tjera juridike dhe fizike si në: pylltari, bujqësi, veterinë, turizëm, ekologji;
4. Dëshmi për shërbimin profesional që do të angazhohet në menaxhimin, duke përfshirë numrin e të punësuarve – gjuetarë të kualifikuar, roje gjuetie, profesionistë të florës dhe faunës;
5. Programi për synimet e menaxhimit dhe zhvillimit të vend gjuetisë – mbrojtja dhe ruajtja, kultivimi dhe shtimi i kafshëve të egra;
6. Dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është i dënuar ose i ndjekur për vepër penale;
7. Dëshmi që vërtetohet se nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të Kosovës;
8. Dëshmi për posedimin e mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie;

KRITERET PËR DHËNJE TË OFERTËS:

- Oferta e cila i plotëson kushtet e lartë cekura dhe ka çmimin më të lartë ofertues për qiranë do të shpallet fitues i këtij projekti.

Afati për tërheqje të materialit ofertues (sipas UA NR. 06/2009) **deri më: 12/04/2018**

Zyra e Bujqësisë, kati parë, Komuna Kaçanik

Afati për dorëzim të ofertave: **13.04/2018 deri ne ora 14:00, Zyra Pritjes, Komuna Kaçanik.**

Hapja e ofertave bëhet me **dt. 13/04/2018, në ora 14:00** në sallën e Kuvendit, kati i katërt.



Fatmir Loku
Drejtor i Drejtorisë për B.ZH.R.P

Fatmir Loku